

## KOMUNA E DRENASIT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDËT BUXHETORE

### Hyrje

Komuna e Drenasit udhëhiqet nga Ramiz Lladrovci i cili përfaqëson subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës. Ai ka ardhur në pozitën e kryetarit pas dorëheqjes së ish-kryetarit Nexhat Demaku. Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Drenas janë zhvilluar në dhjetor 2016. Lladrovci e ka marr pozitën e të parit vetëm pas raundit të dytë të zgjedhjeve.

Sipas UNDP-së, 75% e qytetarëve të Drenasit konsiderojnë se komuna mund t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen ata.<sup>1</sup> Ndërsa, 53% e qytetarëve kanë konsideruar se fondet publike në komunë menaxhohen siç duhet.<sup>2</sup>

Në prag të zgjedhjeve komunale 2013, Instituti GAP kishte identifikuar problemet kryesore të Komunës së Drenasit. Ndër problemet më madhore kishin dalë të jenë: mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm, vërshimet dhe ndotja e lumit Drenica, prezenca e mbeturinave, ndotja e ajrit, mungesa e kanalizimeve, dhe infrastruktura e dobët në shkolla.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>2</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 91 & 92. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr>

<sup>3</sup> Instituti GAP. Problemet Kryesore dhe trendet buxhetore të Komunës së Drenasit 2013. Burim: <http://bit.ly/2wLvO4n> (Qasur me 18.06.2017)

## Problemet aktuale të Komunës së Drenasit

### **Mos funksionimi i aparaturave mjekësore**

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Drenas ka më shumë se një vit që nuk punojnë pajisjet kryesore për diagnostikime dhe trajtime mjekësore. Jashtë funksionit janë rëntgeni kryesor, rëntgeni ndihmës, mungojnë sterilizuesit për pastrimin e pajisjeve mjekësore si dhe në shumicën e kohës mungojnë materialet shpenzuese.<sup>4</sup>

### **Mungesa e ultrazërit dhe momografit**

Shëndetësia në Drenas përballlet me mungesa të aparaturave të nevojshme për ofrimin e shërbimeve. Shtretërit në QKMF janë të vjetruar dhe një pjesë e dritareve në katin e dytë të kësaj qendre janë të thyera. Gjatë dy viteve të kaluara nuk ka pasur kompani të sigurimit për ofrimin e shërbimit të sigurimit në objekt. Përveç kësaj, në Drenas akoma nuk ofrohet shërbimi i monografitë dhe nuk ka as ultrazë. Pacientët në mungesë të këtyre pajisjeve detyrohen të shkojnë në qendrat private ose të udhëtojnë në Prishtinë.

### **Mungesa e asfaltimit të rrugëve**

Janë disa rrugë në fshatrat e Komunës së Drenasit të cilat as nuk janë të asfaltuara dhe as nuk kanë hyrë në kategorinë e rrugëve për t'u shtruar me zhavorr. Në këtë gjendje është rruga disa kilometra e gjatë në fshatin Gllobar, pastaj zona e quajtur Kurtaj në Obri, lagja Halilaj në fshatin Terdevc, dhe dy lagje në fshatin Strubullar.

### **Mbingarkesa me nxënës në shkollën "Rasim Kiqina"**

Sipas udhëzimit administrativ 22/2013 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), numri i nxënësve në një klasë nuk mund të kalojë shifrën prej 35 nxënësve. Ky udhëzim administrativ nuk respektohet në shkollën filllore të ulët "Rasim Kiqina" në Drenas. Numri i nxënësve në klasat e kësaj shkolle sillet nga 43 deri në 46 nxënës. Numri kaq i madh i nxënësve në klasa vlerësohet si faktor negativ për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

### **Bllokimi i trotuareve nga automjetet**

Pjesa me e madhe e trotuareve të qytetit të Drenasit janë të bllokuara nga parkingu i veturave. Qytetarët detyrohen të ecin rrugës së parapare për automjete. Komuna nuk ka bërë deri tani ndonjë investim që do të krijonte hapësira parkingu për automjete dhe kësajsoj të pamundësonte ndaljen e tyre në trotuare.

---

<sup>4</sup> Problemet nëpër komuna janë identifikuar në bazë të intervistave të drejtpërdrejta me përfaqësues komunal, të partive politike, shoqërisë civile, mediave dhe njohëseve të qeverisjes lokale.

### **Mungesa e infrastrukturës në qendrën zejtare**

Zona që është e njohur si Qendra Zejtare në Drenas që përfshin një sipërfaqe relativisht të gjerë ka mangësi evidente infrastrukturore. Aty mungojnë ndriçimi publik, rrjeti i kanalizimit, hapësira për parking të automjeteve, ulëset për qytetarët dhe shportat për hedhjen e mbeturinave të imta. Përveç kësaj, në këtë zonë ka shtëpi të vjetra të cilat po rrenohen dhe në vend të tyre po ndërtohen objekte shumëkatëshe të cilat po e tjetërsojnë karakterin tradicional të kësaj zone.

### **Mungesa e një qendre rinore**

Komuna e Drenasit është ndër komunat e pakta në Kosovë që nuk ka qendër rinore. Përmes kësaj qendre do të mund të zhvilloheshin edhe aktivitete kulturore që nuk janë të shpeshta në këtë komunë. Organizmi i ekspozitave, orëve letrare, orëve të pikturës, muzikës, organizimi i garave në fusha të ndryshme dhe organizimi i aktiviteteve të tjera janë rezultate që në shumicën e rasteve dalin nga qendrat rinore në komunat e tjera.

### **Mungesa e pajisjeve adekuate në njësinë e zjarrfikëseve**

Njësia e zjarrfikëseve në Komunën e Drenasit ka vetëm katër automjete në dispozicion, dy për intervenim dhe dy ndihmëse. Automjeteve nuk u funksionojnë dritat vezulluese, alarmet e as sirenat, madje automjetet për intervenim kanë probleme në hedhjen e ujit (kapaciteti jo i përshtatshëm për hedhjen e ujit, shkaku i vjetërsimit të automjeteve). Kjo gjendje në këtë njësi ka mbizotëruar në të gjitha periudhat.

## **Trendet buxhetore në Komunën e Drenasit (2017)**

Komuna e Drenasit në vitin 2017 ka planifikuar 13.1 milion euro buxhet.<sup>5</sup> Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe 515 mijë euro të tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara.<sup>6</sup> Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013<sup>\*7</sup>, buxheti i Komunës së Drenasit është rritur për 3.5 milionë euro. Kjo rritje në masë të madhe buron nga rritja e granteve qeveritare.

---


<sup>5</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2ugWrKj> dhe Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

<sup>6</sup> Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63 (hapur më 6 shtator 2017).

\*Në këtë vit mjetet e bartura nga të hyrat e pashpenzuara ishin më të ulëta se në 2017 për rreth 130 mijë euro. Shih Raportin vjetor financiar 2012. Ministria e Financave. Burimi: <http://bit.ly/2wKArIf>, faqe 60.


<sup>7</sup> Shih Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

**Figura nr.1:** Buxheti i Komunës së Drenasit 2017



Së bashku me rritjen e buxhetit janë rritur edhe shpenzimet në kategorinë e pagave, investimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve. Rritje më e theksuar e buxhetit është bërë në kategorinë e pagave (7.9 milion euro), ku për dallim nga viti 2013 janë rritur shpenzimet për rreth 1.8 milionë euro, dhe atë të shpenzimeve kapitale që tani ngërthen 1.4 milionë euro më shumë (3.8 milion euro). Ndikim të madh në rritjen e buxhetit për paga kishte vendimi i Qeverisë së Kosovës i vitit 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për 25%.<sup>8</sup> Po ashtu, angazhimi i 36 punonjësve të rinj<sup>9</sup> në periudhën 2013-2016 ka bërë që shpenzimet për paga të rrisin pjesëmarrjen e tyre në buxhetin vjetor të komunës.

**Figura nr.2:** Trendet buxhetore të Drenasit më 2013 dhe 2017




<sup>8</sup> Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M> (hapur më 6 shtator 2017).

<sup>9</sup> Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj> (hapur më 6 shtator 2017).

Të hyrat vetanake të Drenasit kanë pasur ngritje dhe rënie të lehta përgjatë katër viteve të fundit. Gjatë vitit 2016, Drenasi ka realizuar të hyra në vlerë rreth 1.1 milion euro.<sup>10</sup> Kjo shumë është dukshëm më e madhe se të hyrat e realizuara një vit më herët mirëpo më e vogël se ajo e vitit 2014. Kategoria kryesore e të hyrave në Drenas për dallim nga shumë komuna tjera është ajo nga taksat dhe ngarkesat. Krahasuar me vitin paraprak (2015), në 2016 të hyrat nga taksat dhe ngarkesat kanë shënuar rritje rreth 36%.<sup>11</sup> Me fjalë të tjera, rreth 55% e rritjes së të hyrave totale të Drenasit nga 2015 në 2016 është gjeneruar nga kategoria e taksave dhe ngarkesave.

**Figura nr.3:** Të hyrat komunale të Drenasit, 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të përgjithshëm

Krahasuar me vitin 2017, në bazë të planifikimeve buxhetore të Komunës së Drenasit për periudhën 2017–2019<sup>12</sup>, buxheti pritet të jetë vetëm dy përqind më i lartë më 2018 (13.4 milionë euro) dhe katër përqind më i lartë në 2019 (13.7 milionë euro), respektivisht. Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje planifikohet të përdoret për investime kapitale. Ndërsa për kategoritë tjera ndryshimet në ndarjet buxhetore do të jenë minimale.

<sup>10</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Drenasit 2016. Burimi: <http://bit.ly/2j7lcpj> (hapur më 6 shtator 2017).

<sup>11</sup> Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2016 për Komunën e Drenasit. Burimi: <http://bit.ly/1iLOExy> (hapur më 6 shtator 2017).

<sup>12</sup> Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, faqe 186.

## Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Drenasit duhet t'i përmirësojë shërbimet e shëndetësisë.
- Komuna e Drenasit duhet të përzgjedhë operatorin ekonomik që do të merrej me kohë me riparimin e pajisjeve të dëmtuara mjekësore.
- Komuna e Drenasit duhet të ndajë buxhet për blerjen e një ultrazëri dhe momografi.
- Komuna e Drenasit duhet të zgjidhë problemin me mbingarkesë me nxënës në shkollën "Rasim Kiqina", ku në një klasë mësojnë deri në 46 nxënës.
- Komuna e Drenasit duhet të ndajë buxhet për riparimin dhe modernizimin e pajisjeve të zjarrfikëseve.
- Komuna e Drenasit duhet të caktojë një lokacion për ndërtimin e qendrës rinore.
- Komuna e Drenasit duhet të vendos shtylla anti-parking në trotuaret e qytetit.

INSTITUTI GAP  
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*